



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 951 Prot.

Tiranë, më 24. 7-2018

VENDIM Nr. 141, datë 18.07.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7, datë 18.07.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Hidrocentralet Potam 1 dhe Potam 2*" mbi lumin e Potamit, Bashkia Finiq, qarku Vlorë-subjekti "HIDROPOTAM" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Hidrocentralet Potam 1 dhe Potam 2*" mbi lumin e Potamit, Bashkia Finiq, qarku Vlorë-subjekti "HIDROPOTAM" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k.
2. Subjekti "HIDROPOTAM" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Hidrocentralet Potam 1 dhe Potam 2*" mbi lumin e Potamit, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA LUMBARO FERXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO